



## Termat e Referencës

*Ekspert lokal për të ofruar sesione trajnimi me prinderit e femijeve me veshitiresi ne zhvillim dhe aftesi te kufizuar*

Organizata:	Shoqata NDIHMONI JETËN Fshati Prush, Njesia Administrative Vaqarr, Tirane Tel: +355(044)803370 Web site: <a href="http://www.helphelife.org">www.helphelife.org</a> ; E-mail: <a href="mailto:info@helphelife.org.al">info@helphelife.org.al</a>
Projekti:	<b>“Mbështetja në moshë të hershme, një mundësi për zhvillimin e fëmijës”</b>
Koha e angazhimit	10/12/2021 – 11/05/2022
Donator	Bashkia Lezhë në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD)

## Prezantimi

Shoqata “NDIHMONI JETËN” është organizatë Kombëtare jo-fitimprurëse, e ngritur në Tiranë në Shtator 1998, si një inisiativë e një grupei prindërit të fëmijëve me aftesi të kufizuara me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe gjithëpërfshirjen e personave me AK në shoqëri.

Shoqata ka një eksperiencë dhe ekspertizë te ngritur që prej operimit të saj në fushën e trajtimit psiko-socio-edukative të fëmijëve dhe të rinjëve me aftesi të kufizuar, duke ofruar Modele të trajnimit të fëmijëve me aftesi të kufizuar me një ekip multidisiplinar. Referuar kësaj ekspertize, Shoqata ka fokusuar punën e saj në rritjen e kapaciteteve të specialistëve që punojnë me fëmijët me aftesi të kufizuar në institucionet e edukimit parashkollar (çerdhe/kopështe), shkollë, shërbime rehabilituese në qendrën komunitare/qendra ditore, mbështetje në familje, ngritjen e vëtdijes dhe informacionit të prindërve të fëmijëve me aftesi të kufizuar dhe anëtarëve të tjerë të familjes dhe komunitetit, si dhe advokaci dhe lobimin për respektimin e të drejtave të këtij target grupi në zbatim të Konventës për të Drejtat e Personave me AK.

Shoqata, me mbështetjen e ‘Bashkia Lezhë në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD), ka filluar implementimin e Projektit “*Mbeshtetja ne moshe te hershme, një mundesi per zhvillimin e fëmijës*”, i cili implementohet në qytetin e Lezhës.

Projekti është dizenjuar tju vij në ndihmë fëmijëve me aftesi të kufizuar dhe ata me vështirësi në zhvillim që ndjekin Institucionet e edukimit të hershëm në qytetin e Lezhës. Kjo gjë do të arrihet duke trajnuar edukatoret e institucioneve të edukimit të hershëm, si dhe stafit mbështetës që punon për zhvillimin e fëmijëve me vështirësi në zhvillim në këto institucione dhe prindërit e tyre. Gjithashtu, projekti do të ngrej Rrjetin lokal të Institucioneve publike dhe private që punojnë me/për fëmijët me aftesi të kufizuar, në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë Lezhës duke u fokusuar në ngritjen e kapaciteteve të tyre në drejtim të fëmijëve me AK.

**Objektivat kryesore dhe rezultatet e projektit janë:**

## **Objktivi i Përgjithshëm:**

Të permiresojme kapacitet e femijeve me veshtiresi ne zhvillim ne drejtim te zhvillimit mendor, social dhe educative, dhe ti ndihmojnë ata të kenë një jetë të pavarur dhe gjitheperfshirese ne komunitet.

## **Objektivat Specifikë:**

**OS.1.** Të rris kapacitetet e prindërve të fëmijëve me vështirësi në zhvillim dhe punonjesve te edukimit te hershem të identifikojnë dhe mbështesin zhvillimin e fëmijëve me veshtiresi ne zhvillim, dhe rrisin aksesin ne sherbime cilesore.

**OS.2** Te rritet niveli i ndërgjegjësimit te institucioneve (shendetesore, arsimore, punesimit, ofrues sherbimi, etj) ne nivel lokal dhe anetare te tjere te komunitetit ne bashkine Lezhe për të adresuar më mirë nevojat e PAK.

*Në kuadër të implementimit të këtij projekti, Shoqata Ndihamoni Jetën kërkon të kontraktoj një ekspert, të aftë për të demonstruar aftësi teknike dhe humane për të ofruar trajnime me prinderit e femijeve me AK të qarkut Lezhë.*

## **Qëllimi i shërbimit:**

Eksperti lokal do të angazhohet në ofrimin e sesioneve te trajnimit per prinderit e femijeve qe jane ne cerdhet dhe kopeshtet te qarkut Lezhe sipas moduleve tw pwrgatitura nga Shoqata Ndihamoni Jeten për të rritur kapacitet e tyre ne drejtim te trajtimit te femijeve te tyre dhe identifikimit te tyre te hershem, manaxhimin e sjelljeve te papershtatshme ne kushtet e shtepise, etj.

## **Metodologja**

Sesionet e trajnimit do të ofrohen bazuar në metodën me pjesëmarrje duke ju dhënë pjesëmarrësve mundësinë të ndajnë eksperiencat e tyre, pritshmëritë dhe duke i përfshirë ata në ushtrime për të përforcuar elementët që do tju prezantohen gjatë sesioneve dhe se si ato do të influencojnë në zhvillimin e fëmijëve. Trajnimi do te organizohet duke u bazuar ne 2 Manualet e pergatitur nga Shoqata Ndihamoni Jeten te cilet sesione trajnimi do te ofrohen per prinderit te cilat do te organizohen online dhe ne presence, kjo ne varesi te situates qe do te jete present si rezultat i Covid-19.

## **Përgjegjësitë e ekspertit**

Nën supervizimin direkt të Koordinatorit të Projektit, Eksperti pritet të:

- Ofroj sesionet informimi/edukimi të prinderve, sipas një kalendarri mbi të cilën do të bihet dakort midis dy palëve;
- Të përgatis të gjitha materialet që do tju shpërndahen pjesëmarrësve gjatë trajnimit;
- Të përgatis axhendën e trajnimit duke u kujdesur që të jetë sa më gjithëpërfshirëse;
- Të përgatis vlerësimet e para/pas trajnimit për pjesëmarrësit e përfshirë në trajnim sipas formatit të mundësuar nga Ndihamoni Jetën;
- Të këshillohet me Ndihamoni Jetën në advance për cdo ndryshim në kalendarin e sesioneve të trajnimit;
- Të përgatis një raport final në fund të sesionit të trajnimit ku të përfshihen feedback i pjesëmarrësve.

## **Përgjegjësitë e Ndihamoni Jetën**

- Të siguroj pjesëmarrjen e prinderve në çdo session trajnimi, kjo në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të Bashkisë Lezhë.

- Te siguroj transportin e ekspertit ne trajnim.

**Vendi i konsulencës:** Lezhë

**Kohëzgjatja e konsulencës:** 10 Dhjetor 2021 – 15 Prill 2022

**Politikat e mbrojtjes së fëmijëve të Ndihamoni Jetën:**

Personat që do të punojnë me Kontrata Shërbimi për Ndihamoni Jetën duhet të pranojnë me shkrim se ata kanë kuptuar “Politikën e Ndihamoni Jetën për Mbrojtjen e Fëmijëve” dhe standartet që përcakton kjo politike.

**Kualifikimi ose eksperiencia që kërkohet**

Eksperti duhet të përmbushi kërkesat si më poshtë:

- Të zotëroj një diplomë universiteti në fushen e zhvillimit te femijes (Psikiater zhvillimi, Psikologji apo Pune Sociale);
- Të ketë minimum 5 vite eksperiencë profesionale në fushën e zhvillimit të fëmijëve;
- Eksperiencia të mëparshme në ofrimin e trajnimeve me fokus fëmijët me AK;
- Njohuri mbi situatën e të drejtave të fëmijëve me AK në Shqipëri si dhe legjislacionin shqiptar;
- Aftësi shumë të mira në komunikim dhe shkrim raporti;
- Aftësi për të punuar me pak supervizim dhe nën presion.

Kandidatët e interesuar të cilët i plotësojnë kriteret e parashkruara në këto Terma Reference, mund të dorrëzojnë dokumentat e mëposhtëm brenda dt.6 Dhjetor 2021:

- Letër motivimi që spjegon motivimin tuaj për të aplikuar për këtë pozicion dhe se si ju I plotësoni kriteret.
- CV e detajuar
- Diploma

Vetëm kandidatët e përzgjedhur për fazën e intervistës do të njoftohen.

Aplikimet tuaja mund ti dërgoni në këtë adresë e-maili: info@helphelife.org.al ose në adresën postare: Shoqata Ndihamoni Jetën, Fshati Prush, Njësia Administrative Vaqarr, Tiranë.

**Përzgjedhja e ekspertit do të bëhet bazuar në atë:**

- Se sa mirë do të plotësoj kërkesat e parashtuara në Termat e referencës.
- Eksperiencat e ngjashme.

**Gjatë proçesit të vlerësimit do të kenë prioritet aplikuesit nga Bashkia Lezhë**